



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:184475

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05679774

A.nr. 2164/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditësit, R.F. nga ..., me adresë ..., kundër të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Departamenti i Pensioneve, në Prishtinë, për shkak të anulimit të aktvendimit, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në mungesë të palëve ndërgjyqës, me datë 16.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet kërkesëpadia e paditësit ..., me të cilën ka kërkuar që të anulohet aktvendimi me numër 5506 i datës 26.07.2022, i të paditurës, Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të Ligjit Nr.03/L-202 për Konfliktin Administrativ, në mungesë të palëve së ndërgjyqës të ftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore.

Paditësi me padinë e parashtruar në gjykatë me datën 08.09.2022, ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadia e tij të aprovohet si e bazuar ashtu që të anulohet vendimi me numër të dosjes 5506 i datës 26.07.2022 si i kundërligjshëm dhe gjykata ta aprovojë kërkesën e paditësit për njohjen e të drejtës në pension Paraplegjik dhe Tetraplegjik në grupin e parë dhe të drejtën për përcjellës, nga dita e padisë e ne vazhdim deri sa te ekzistojnë kushtet ligjore për pagës, sipas afateve të arritjes për pagës, me kërcenim të përmbarimit me dhunë. Më tej, paditësi ka theksuar se e paditura me këtë vendim ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit 05/L-067, si dhe Rregullores nr.07/2017 për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave paraplegjik dhe tetraplegjik.

E paditura në përgjigjen në padi të datës të parashtruar me datë 01.12.2023, dhe me parashtrësën e datës 28.02.2024, e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, vendimi është marrë konform dispozitave ligjore dhe i propozon gjykatës që pas administrimit të provave të marr aktgjykim për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit në tërësi si të pabazuar, duke lënë në fuqi vendimin e të paditurës. Më tej ka theksuar se paditësja pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të lëndës ka vërtetuar se kërkesa e paditësit nuk është në harmoni me nenin 8 pika 1 e Ligjit Nr.05/L-067 ngase bazuar në vlerësimin e Komisionit Mjekësorë të datës 24.02.2022 nga mjekë specialist të lëmis përkatëse kanë konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet për kompensimin për personat paraplegjik dhe tetraplegjik dhe në procedurën sipas ankesës e paditura e ka refuzuar të njëjtën duke e lënë në fuqi vendimin e organit të shkallës së parë.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor-publik të datës 16.04.2024 ka administruar provat relevante: vendimi i dt.26.07.2022; Aktgjykimi i dt.21.01.2022 me numër A.nr.764/2019; ankesa e dt.01.11.2018 me numër 03/704; shkresa me numër 2039/97; shkresa e dt.16.08.2007 dhe e dt.12.09.2007; raporti mjekësor 23.08.04; raporti konziliar i dt.05.07.2018 me numër 1009; aktvendimi i dt.17.12.2004; kopja e letërnjoftimit për paditësin e dt.26.02.2021; vendimi i dt.28.02.2019; vendimi i dt.01.10.2018; ankesa e dt.01.11.2018 i dt.03/704; ekstrakti nga regjistri qendror i gjendjes civile i dt.01.06.2018; ekstrakti nga regjistri qendror i gjendjes civile për ...in e dt.05.07.2018; Komisioni vlerësues për njohjen e statutit dhe te drejtave te personave paraplegjik dhe tetraplegjik i vitit 1997 – Ekzaminimi i dt.12.09.2018; shqyrtimi i ankesave i dt.26.11.2018- shqyrtimi i lendeve pas aktgjykimit te gjykatës i dt.22.07.2022.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të goditur në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Me vendimin kontestues të paditurës të datës 26.07.2022 gjykata gjen se, është refuzuar ankesa e paditësit në kompensim të personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik të grupit të parë për arsye se nuk janë plotësuar kushtet ligjore në kuptim të nenit 7 dhe pikën 1 dhe të nenit 8 te Ligjit 05/L-067 dhe mbi këtë bazë është refuzuar ankesa për kompensim në grupin e parë.

I pakënaqur me vendimin e lartcekur, paditësi ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datë 08.09.2022, duke kontestuar ligjshmërinë e tij

Gjykata i vlerësoi të pabazuara pretendimet e paditësit në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor se paditësit i takon e drejta për njohjen e të drejtës në kompensimin për personat paraplegjik dhe teraplegjik. Me nenin 3 të Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik përcakton se: “ 1.1 Paraplegjikët – janë personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo

periferik kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme. 1.2. Tetraplegjikët – ose (kuadriplegjikët) – janë personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmëtimit të sistemit nervor qendror apo periferik kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme”,.

Po ashtu me nenin 7 paragrafi 1 dhe 2 i po të njëjti Ligj përcakton se: “1. Përfituesit e këtij ligji, marrin nga buxheti shtetëror kompensimin në një shkallë të caktuar, bazuar në pagën minimale në Kosovë, dhe përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria, sipas propozimit të MPMS, 2. Përfituesit e këtij ligji, në bazë të vlerësimit nga komisioni vlerësues, të cilët kanë pasoja të përhershme dhe të plota në inkontinencë, përdorin medikamente në baza ditore, kanë humbje të ndjeshmërisë së plotë të ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të plagëve dekubitare marrin një shumë shtesë prej pesëdhjetë përqind (50%) të kompensimit nga paragrafi 1 i këtij neni”, kurse me nenin 8 të këtij ligji përcaktohet: “1. Përfituesve të këtij ligji u njihet e drejta për një kujdestar personal, në bazë të vlerësimit nga komisioni vlerësues, me qëllim të ofrimit të kujdesit dhe shërbimeve të domosdoshme ditore, e të cilët kompensohen në shumën e njëjtë sikurse përfituesit e këtij ligji”, andaj bazuar në provat të administruara përjashtohet humbjen e ndjeshmërisë së plotë të ekstremiteteve ashtu siç e parasheh nen 7 paragrafi 1 dhe 2 neni dhe 3 i Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik dhe po ashtu nuk dëshmojnë plotësimi i kushteve për aplikimin e nenit 8 paragrafi 1 i këtij ligji

Kjo gjykatë duke vlerësuar ligjshmërinë aktvendimit kontestues ka konstatuar se, organet administrative, drejtë kanë zbatuar dispozitën e Ligjit 05/L-067 për Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik , respektivisht nenin 7, pikën 2, si dhe nenit 8 pikën 1 në bazë të të cilit edhe është refuzuar kërkesa respektivisht ankesa e paditësit, që t’i njihet e drejta në Pensionin e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik ne grupin e parë, meqenëse, ankuesi para komisioneve mjekësore nuk i ka ofruar dëshmi të mjaftueshme që dëshmon se, i plotëson kriteret e përcaktuara të ligjit në zbatim.

Prandaj, gjykata vlerëson se, në këtë çështje administrative, drejt është vërtetuar gjendja faktike nga i padituri, drejt ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative dhe të ligjit material, kur ka refuzuar ankesën- këtu paditësit në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik në grupin e parë. Me tej, gjykata vëren se paditësi sipas vendimit të datës 28.02.2019 e ka realizuar të drejtën në kompensimin për personat paraplegjik dhe tetraplegjik, në bazë të secilës i është njohur e drejta në grupin e dytë konform paragrafit 1.1 të nenit 3 dhe të pikës 1 të nenit 7 të Ligjit 05/L-067 përkatësisht vlerësimit të komisionit mjekësor të datës 12.09.2018 për tre vite radhazi.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e paditësit të dhëna në padi, por të njëjtat pretendime i refuzoi si të pa bazuara, nga arsyeja se paditësi të njëjtat nuk i ka provuar me fakte dhe prova të cilat kishin me

ndikuar që kjo gjykatë të mund të vërtetoj një tjetër të gjendje faktike nga ajo që ka vërtetuar organi i paditur.

Nga kjo gjendje e konstatuar si me lart, gjykata vlerëson se aktvendimi kontestues, është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe organet administrative drejtë kanë zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative, drejtë kanë vërtetuar gjendjen faktike drejtë e ka zbatuar ligjin material, kur kanë refuzuar ankesën e paditësit . Andaj, mbi këto arsye kjo gjykatë kërkesëpadinë e paditësit nuk e aprovoj sepse sipas vlerësimit të gjykatës nuk është cënuar ligji në dëm të paditësit.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.parg.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE
A.nr. 2164/2022, data 16.04.2024

G j y q t a r e
Luljeta Maxhuni

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.